



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 210, Datë 28.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A
KESH)” SH.A. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK, ME VENDNDOHJE NË DIGËN E
ZADEJËS TË HEC-IT VAU I DEJËS, QARKU SHKODËR, ME KAPACITET TË
INSTALUAR PREJ 8.25 MW**

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, gërma “a” dhe 41, pika 1, gërma “a” dhe nenit 136 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2180/1 prot., datë 24.07.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2180 prot., datë 20.07.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Digën e Zadejës të HEC-it Vau i Dejës, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar prej 8.25 MW.
- Për sa i përket kapacitetit të instaluar, rezulton se shoqëria ka paraqitur kërkesën e saj për 8.25 MW, sikurse përcaktuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 671, datë 30.10.2024, dhe në kontratën e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Sa konstatuar nga dokumentacioni tjetër i këtij aplikimi, Vendimi për VNM Paraprake dhe miratimi në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit janë dhënë për fuqinë 8.25 MWp, ndërkohë që miratimi në parim ka humbur dhe vlefshmërinë e tij, ndaj vlerësohet që në vijim të bëhen sqarimet/saktësimet përkatëse me shoqërinë në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (b, d dhe f).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a.

- Është pajisur me VKM-në nr. 671, datë 30.10.2024 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Digën e Zadejës, HEC “Vau i Dejës”, Qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.”.
- Ka nënshkruar me MIE-n Kontratën nr. 3131 rep., nr. 1557 kol., në datën 30.05.2025 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 8.25 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Digën e Zadejës, HEC Vau i Dejës, Qarku Shkodër, nga shoqëria KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH) SH.A.”;
- Ka marrë miratimin paraprak për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së OST sh.a. nr. 1724/3 prot., datë 22.04.2024, me lëndë: “Miratim në parim i kërkesës për lidhjen me Impiantin Fotovoltaike në digën e Zadejës, me fuqi të instaluar prej 8.25 MWp, me rrjetin e transmetimit”.
- Është pajisur me VNM Paraprake, me nr. ANI 90120240001, lëshuar më 06.03.2024, Komisioni 30, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “*INSTALIMI I IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË DIGËN E ZADEJËS HEC VAU I DEJËS, ME FUQI TË INSTALUAR 8.25 MWp*”.
- Është pajisur me Lejen e Ndërtimit të datës 03.07.2025.
- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin si vijon:

NENI 9, Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”:** të përditësojë/përcjellë informacionin përkatës për ndërtimin e centralit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1. Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”:** garancinë për panelet, në rast se e disponon një të tillë, si dhe të plotësojë të dhënat në lidhje me numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës.
 - **gërma “c”:** miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit.
 - **gërma “e”:** raportimet e dërguara në MIE në kuadër të ecurisë së projektit.
- Rezulton se Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 936/1, datë 14.02.2024, Plani i Biznesit dhe Kontrata e nënshkruar me MIE-n janë depozituar në format fotokopje, ndaj në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 3 të rregullores, vlerësohet t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë këtë dokumentacion në ERE në format origjinal, ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
- Vlerësohet që ERE të njoftojë MIE-n dhe Komitetin e Digave të Mëdha për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.
- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE. Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 8.25 MW, me vendndodhje në Digën e Zadejës, HEC Vau i Dejës, Qarku Shkodër.
2. Shoqëria “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a. të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet përkatëse të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” të ndryshuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Komitetin e Digave të Mëdha, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI